

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ZigZag”

I. THEMELIMI

NENI 1
Ortaket themelues

Shoqeria krijohet nga ortaket themelues sot me date 24.02.2025:

- **Z. Jorgen Konini**, shtetas shqiptar, lindur me 17.08.1996, ne Korçe, Shqiperi, me ID me nr. personal J60817090D, madhor me zotesi te plote per te vepruar

II. EMERTIMI, SELIA, FORMA JURIDIKE DHE OBEJKT

NENI 2
Emertimi

Shoqeria emertohet “ZigZag”

NENI 3
Forma Juridike

Forma juridike do te jete Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k) sipas Ligjit nr. 9901 data 14.04.2008 “Per shoqerite tregtare”

NENI 4
Selia

4.1 Shoqeria “ZigZag” e ka seline e saj ne adresen: Tirane Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga Dritan Hoxha, Pallati Green invest-2008 SHPK, Kati 0-0

4.2 Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tille mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë ose jashte saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqërisë dhe do te veproje nen mbikqyrjen e Administratoreve te "ZigZag" Shpk.

NENI 5

Objekti i veprimtarise se Shoqërisë

- 5.1 Ushtrimi i aktiviteteve ne fushen e turizmit dhe te udhetimeve e transportit turistik. Organizimin e udhetimeve dhe pushimeve individuale ose kolektive per shtetasit shqiptar dhe te huaj brenda dhe jashte vendit dhe ndermjetesimin per shitjen e produkteve turistike nete gjitha format e tij. Sherbime qe mund te ofrohen ne rastin e udhetimeve dhe pushimeve si: Rezervimi i vendeve te fjetjes ne njesite akomoduese turistike si hotele, vila etj. Rezervimi dhe shitja e biletave perlinjat ajrore dhe detare etj. Rezervimi i vendeve, mjeteve te transportit turistike.
- 5.2 Sherbime te Bar-Kafe
- 5.3 Zhvillimi i moduleve software dhe programeve kompjuterike si dhe ofrimi i sherbimeve te publicitetit dhe marketingut te te gjitha formave, perfshire ketu edhe publiciteti e marketingu duke perdorur metoda inovative, te komunikimit ne distance, te perdorimit te teknologjive te reja, websiteve, rrjeteve sociale etj.
- 5.4 Ushtrimi i aktiviteteve te kembimit valutor. Veprimtari te agentit per transferta parash, sherbimin e pagesave, ndermjetesimit ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke.
- 5.5 Kurse trajnimi, master, seminare, uebinarë, transmetime në internet dhe çdo formë tjetër përhapjeje në fushën teknologjike, teknologjive të informacionit, fusha të tjera të lidhura si Inxhinieri Sistemes, Rrjeta Kompjuterike, Administrim Serverash, Siguri Kibernetike, Virtualizim dhe Kontejnerë, Open Source, IoT, Cloud Computing, Big Data, Inteligjenca Artificiale, Gjuhët e Programimit, Baza e të Dhënave, DevOps dhe Blockchain. Ofrimi i trajnimeve mund të kryhet personalisht, drejtpërdrejt në distancë ose përmes krijimit të produkteve trajnuese për përdorim në vetë-studim që përdorin teknologjitë më të fundit dhe metodologjitë edukative si realiteti virtual dhe platformat elektronike te elearning etj.
- 5.6 Shoqeria mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjetër qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme brenda kufinjve te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, si dhe mund te kryeje cdo operacion tregtimi ose financimi qe lidhet drejtpërdrejt ose terthorazi me objektin e shoqërisë.
- 5.7 Shoqeria me vendim te Administratorit, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqëri apo sipermarrje te tjera, si dhe te kryeje cdo veprim tregtar qe konsiderohet i nevojshem me qellim arritjen e objektit te veprimtarise se saj.
- 5.8 Objekti i shoqërisë mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit te Asamblese se Pergjithshme.

III. KOHEZGJATJA-KAPITALI I SHOQERISE-VENDIMARRJA

NENI 6

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

NENI 7

Kapitali i Shoqerise

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 2,500,000 (dy million e peseqindmije) Leke dhe nuk eshte e paguar.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise:

- **Jorgen Konini** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 2,500,000 (dy million e peseqindmije) Leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 8

Asambleja e Pergjithshme

8.1 Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet qe ligji apo Statuti ia rezervon ketij organi, si dhe ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblese se Pergjithshme.

8.2 Vendimet e Asamblese merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se "ZigZag" Shpk

8.3 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese se Ortakeve marrja e vendimeve persa i perket:

- Ndryshimin e Statutit
- Riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likudjimi, shnderrimi i shoqerise
- Zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, si dhe blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre.
- Emerimi dhe shkarkimi i Administratorit
- Emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel
- Miratimi i bilancit

- Si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblese

NENI 9

Organet drejtuese

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- a) Asambleja e Pergjithshme ne te cilen marrin pjese Ortaket e Shoqerise ose perfaqesuesit e tyre te pajisur me prokure te vecante dhe;
- b) Administratori/ret

NENI 10

Administratori

10.1 Shoqeria administrohet nga Administratori, person fizik qe mund te jete ose jo Ortak i Shoqerise.

10.2 Administratori eshte i detyruar te drejtoje shoqerine ne perputhje me Ligjin "Per shoqerite tregtare". Statutin, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe sipas dispozitave te tjera ligjore ne fuqi.

10.3 Administratori i Shoqerise emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakeve, si dhe do te qendroje ne detyre per nje kohe prej 5 vjetesh.



10.4. Ne rast se ka me shume se nje Administrator, ata punojne bashkarisht ose vec e vec per te perfaqesuar shoqerine dhe interesat e shoqerise.

10.5 Administratoret e pare te Shoqerise emerohen:

- **Z. Jorgen Konini**, shtetas shqiptar, lindur me 17.08.1996, ne Korçe, Shqiperi, me ID me nr. personal J60817090D, madhor me zotesi te plote per te vepruar

Nenshkrimi i Administratoreve:

Jorgen Konini



10.6 Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.

NENI 11

Ligji i zbatueshem dhe mosmarreshjet

11.1 Per sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, reference i behet legjislacionit shqiptar ne fuqi.

11.2 Per te gjitha mosmarreshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent do jete e Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

11.3 Ky dokument redaktohet ne 4 (kater) kopje origjinale.

11.4 Per kryerjen e procedurave te regjistrimit prane QKB-se autorizohet administratori qe te perfaqesoje shoqerine per te gjitha veprimet e nevojshme prane ketij institucioni.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaket themelues

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Jorgen Konini

